



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË

V E N D I M

PËR NJOFTIMIN E AKUZËS DHE MARRJEN E PERSONIT TË PANDEHUR

Në, Tiranë me 07.01.2020.

Unë, Kolë Hysenaj, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me juridiksion të Përgjithshëm, në bazë të nenit 34 të K. Pr. Penale, me këtë akt i njoftoj akuzën personit që merr cilësinë e të pandehurit Agim Kajmaku.

K O N S T A T O V A :

Se, në Prokurorinë pranë Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë me juridiksion të përgjithshëm, zhvillohen hetime në çështjen penale nr.8185, rregjistruar me datën 30.10.2019 për veprën penale të: "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 190/1 i K.Penal, "Falsifikimi i dokumenteve zyrtarë", e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 186 i K.Penal si dhe "Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij", e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 249 i K.Penal, në ngarkim të shtetasit Agim Kajmaku, etj;

Nga aktet e hetimeve paraprake të administruara në këtë procedim penal rezulton se:

Shtetasi Agim Kajmaku në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar, si dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, vendim nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, neni 11, ka plotësuar formularin e vetdeklarimit dhe më pas është përcjellë në institucionet zyrtare, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve Tiranë, pasi shtetasi Agim Kajmaku ishte subjekt i këtij vetdeklarimi, sepse kishte kandiduar në Zgjedhjet Vëndore 2019 për Kryetar të Bashkisë Vorë.

Subjekti i vetdeklarimit, shtetasi Agim Kajmaku ka plotësuar formularin e vetdeklarimit, formulari i cili mban datë 12.05.2019, i dorëzuar në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve me datën 13.05 në të cilin në rubrikën III, "Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit", pika nr.3, "A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autootitet i huaj, për kryerjen e një veprë penale? Ky subjekt i është përgjigjur me "Jo".

Subjekti i vetdeklarimit, shtetas Agim Kajmaku përsëri në plotësimin e këtij formulari ka paraqitur rrethana të rreme, të cilat bien ndesh edhe me të dhënat që ai ka paraqitur në rubrikën "B" të këtij formulari. Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër qoftë edhe pa e ndryshuar zuyrtarisht , listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. Në këtë rubrikë subjekti ka shënuar "Emër: Jorgo, mbiemër: Tota".

Me shkresën nr.14197, datë 27.08.2019, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në zbatim të Ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", (të ndryshuar), si dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, vendim nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, ka dërguar formularin e subjektit Agim Kajmaku në Prokurorinë e Përgjithshme, protokolluar me datën me nr.2193/12 prot, datë 27.08.2019 në K'të prokurori, kërkesë me të cilën KQZ ka kërkuar zbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga neni 8 pika 1 e ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", (të ndryshuar), si dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, vendim nr.17/2016, kreu V, pika

nr.92, datë 31.10.2019 shtetësi Gentian Picari është emëruar me detyrë "Zëvendëskryetar" Bashkia Vorë, urdhër i protokolluar me nr.2314/2, datë 31.10.2019 në librin e protokollit të bashkisë . Këto urdhëra janë jo vetëm bërë me datën 01.01.2019, pas vendimit të KQZ-së por kanë edhe rrjedhoë jologjike me njëri tjetrin. Shtetasi Gentian Picari është emëruar zëvendëskryetar i Bashkia Vorë me urdhërin nr.92, datë 31.10.2019, ndërkohë që është larguar nga detyra e mëoarshme me urdhërin nr.145, datë 31.10.2019, pra kur është emëruar në detyrën e dytë mbante edhe detyrën e Drejtorit të kabinetit, çka tregon se urdhërat kanë qënë fiktivë e për rrjedhojë nuk kanë arritur dot as në renditjen e saktë të tyre. Ndërkohë që urdhëri nr.144, për shtetasen Yme Gërdeci, protokolluar me nr.2265, datë 31.10.2019 në librin e protokollit nuk ka lidhje me shtetasin Gentian Picari dhe protokollimi me fraksion është pikërisht në falsifikim të dokumentit zyrtar. Protokollimi në rregjistrin e korrespondencës së Bashkia Vorë është bërë me datën 31.10.2019 dhe përfundon me këta urdhëra, çka tregon se të gjithë fraksionet në këtë protokoll janë shtuar ditën e nesërme pasi nuk kanë qënë akoma të dalë këta urdhëra. Nëse urdhëri me nr.92, datë 31.10.2019 do të ishte i kësaj ditë duhej të ishte protokolluar 53 numra protokollit më poshtë që në shkallë zbritje në rendin numerik (145 urdhëri i emërimit- 92 numëri i lirimt = 53) e për rrjedhojë duhej të ishte protokolluar me nr.2261 prot, datë 29.10.2019, gjë e cila nuk ka ndodhur pasi në atë datë ky urdhër nuk ka ekzistuar.

Përveç sa më sipër në librin e korrespondencës është ndërhyre me fraksion edhe ne numra të tjerë protokollit, duke shpallur fitues tenderi, etj, veprime që janë bërë nga ish Kryetari i Bashkia Vorë.

Gjithashtu rezulton e provuar se shtetasi Agim Kajmaku ka hyrë në ambientet e Bashkia Vorë pasi nuk ka patur mandat, sepse Vendimi i Komisionit Qëndrot të Zgjedhjeve është menjëherë i ekzekutueshëm, dhe në bashkëpunim me shtetaset Merita Shytko dhe Irma Bylyku, duke veprimet e falsifikimit të dokumentit zyrtar . Kjo shtetase , punonjëse e kësaj bashkie, ka kryer ka shënuar në urdhërat që kanë dalë: Konceptoi: Merita Shytko dhe Miratoi: Merita Shytko, si dhe punonjësja e protokollit me emrin Irma Bylyku, e cila i ka protokolluar me datë të shkuar ndërkohë, që në atë datë ajo nuk i kishte këto urdhëra fizikisht në dorë. Kryerja e këtyre veprimeve përbën elementë të figurave të krimin për të cilat janë zhvilluar hetime e konkretisht janë: "Falsifikimi i dokumenteve" e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 186 i K.Penal, e kryer në bashkëpunim, "Falsifikimi kompjuterik", e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 186/a, i K.Penal(shtuar me ligjin nr.10023, datë 27.11.2008, neni 18), vepra penale në ngarkim të shtetasve Agim Kajmaku, Merita Shytko dhe Irma Bylyku. Në deklarin e saj datë 08.11.2019 shtetësj Irma Bylyku ka dekaluar e: "... urdhërat mi kanë sjellë në zyrën e protokollit asistejnta e kryetarit shtetësj Mirjeta Mema. Urdhërat me firmën e shtetasit Agim Kajmaku (tre urdhëra liimi dhe një emërimi) mi kanë sjellë shtetësj Mirjeta Mema. Me sa mbaj mend vazhdon ajo mi ka sjellë rreth ores 12 të datës 01.11.2019....".

Gjithashtu rezulton se shtetasi Agim Kajmaku ka vepruar pas përfundimit të detyrës pasi ishte vënë në dijeni të Vendimit të KQZ-së, vendim nr.1101, datë 01.11.2019, ora 11:00 vendim i cili menjëherë është bërë publik nga KQZ-ja si dhe të gjitha mediat shqipëtare, si dhe është botuar në fletoren zyrtare nr.152, datë 13.11.2019, në të cilin shkruhet: Komisioni Qqndror i Zgjedhjeve:

VENDOSI: 1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Vorë, qarku Tiranë, z. Agim Ymer Kajmaku.

2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në gjykimin e zhvilluar në të KQZ-së, nuk ka qënë prezent ish Kryebashkiaku i Bashkisë Vorë, shtetasi Agim Kajmaku,, i cili është përfaqësuar nga avokati i zgjedhur nga ana e Tij, z.Isuf Shehu, vendim i cili është shpallur dhe bërë publik menjëherë.

Në rrethnata e mësipërme shtetasi Agim Kajmaku ka konsumuar edhe elementët e veprës penale të: "Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij", e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 249 i K.Penal. Nga administrimi në tërësi i akteve pjesë e procedimit penal, rezulton e provuar tejet dyshimi se nga ana e shtetasit Agim Kajmaku janë konsumuar plotësisht elementët e veprës penale të Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 190/1 i K.Penal, 2- "Falsifikimi i dokumenteve zyrtarë", e kryer në bashkëpunim, parashikuar dhe e dënueshme nga neni 186/2 i K.Penal si dhe "Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij", e parashikuar dhe e dënueshme



nga neni 249 i K.Penal dhe për këtë do të procedohet me marrjen të pandehur dhe komunikimin e akuzës ndaj tij.

Aktet proceduriale penale, që do të përdoren për marrjen e këtij vendimi janë si më poshtë listuar:

1. Formulari i vetëdeklarimit në emrin e shtetasit Agim Kajmaku, formulari i cili mban datë 12.05.2019, dorëzuar në KQZ.
2. Shkresë me shkresën nr.2193/71, datë 28.10.2019 ardhur për kompetencë nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe e Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose ushtrojnë Funksione Publike(së bashku me të gjithë materiaslin bashkëngjitur).
3. Shkresë e ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën Nr.V-2629/1 prot, datë 27.08.2019, në përgjigje të shkresës së Prokurorinës së Përgjithshme, shkresë nr.2193/9, datë 26.08.2019 ka paraqitur dokumentin "Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore" Nr.11, datë 27.08.2019". në të cilin rezulton se subjekti Agim Ymer Kajmaku (Jorgo Toto), figuron me statusin "i padënuar".
4. Shkresë nr. 2193/9 prot, datë ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në të cilën është konfirmuar se: të dhënat personale të subjektit Agim Kajmaku, sipas Rregjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave shtetasi Agim Kajmaku me datën 06.02.1996 ka ndryshuar përbërësit e Gjendjes Civile në rubrikën emri/mbiemri nga "Agim Kajmaku" në "Jorgo Toto". Ndërsa me datën 30.03.2004 e ka ndryshuar përsëri këtë përbërës nga "Jorgo Toto" në "Agim Kajmaku", identitet të cilin e mban edhe aktualisht.
5. Vërtetim i gjendjes gjyqësore me nr.11, datë 27.08.2019 për shtetasin Agim Kajmaku (Jorgo Toto).
6. Vendimit nr.1101, datë 01.11.2019, ora 11:00 i të KQZ-së, botuar në fletoren zyrtare nr.152, datë 13.11.2019, në të cilin shkruhet: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve:
7. Procesverbal "Për kqyrjen e marrjen e dokumenteve", datë 07.11.2019.
8. Urdhër nr.92, nr.145, nr.146, nr.147, datë 31.10.2019 për shtetasit Gentian Picari, Hekuran Brahimaj dhe Laureta Omeraj.
9. Procesverbal "Për marrjen e të dhënave nga personi tregon rrethanat e dobishme për hetimit", i shtetasit Durim Sina, datë 09.11.2019.
10. Procesverbal "Për marrjen e të dhënave nga personi tregon rrethanat e dobishme për hetimit", i shtetasit Laureta Omeri, datë 07.11.2019.
11. Procesverbal "Për marrjen e të dhënave nga personi tregon rrethanat e dobishme për hetimit", i shtetasit Hekuran Brahimaj, datë 07.11.2019.
12. Procesverbal "Për marrjen e të dhënave nga personi tregon rrethanat e dobishme për hetimit", i shtetasit Gentian Picari, datë 12.11.2019.
13. Procesverbal "Për sekuestrimin e dokumenteve", datë 06 dhe 08.11.2019.
14. Procesverbal "Për kqyrjen e kamerave të sigurisë" Bashkia Vorë, datë 19.11.2019.
15. Procesverbal "Për kqyrjen e aparatit celular të shtetasit Gentian Picari", datë 13.11.2019.
16. Procesverbal i kqyrjes së dokumentacionit të ardhur nga kompania celulare "Vodafone", në përgjigje të shkresës Tonë nr.16689 prot, datë 12.11.2019 dhe nr.16794, datë 14.11.2019 (Shtetasi Agim Kajmaku komunikon nga numri celular +355696090996, i shtetasës Vildane Ahmetaj, bashkëshortja e shtetasit Lavdi Kajmaku, nipi i shtetasit Agim Kajmaku).
17. Çertifikatë familjare e shtetasit Shefqet Kajmaku, lëshuar nga Komuna Prezë.
18. Procesverbal "Për kqyrjen së kamerave të sigurisë së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, datë 14.11.2019, si dhe si dhe në tërësi aktet proceduriale të administruara në procedimin penal nr.8185, rregjistruar me datën 30.10.2019.

Dispozita ligjore të zbatueshme:

- 1- Neni 190 i K.Penal "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", parashikon "Falsifikimi ose përdorimi i vulave, i stampave, apo i formularëve të falsifikuar ose paraqitja e rrethanave të rreme në këto të fundit, që u drejtohen organeve shtetërore, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet".



- 2- Neni 186/2 "Falsifikimi i dokumenteve", parashikon se: "Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara, kur kryhet në bashkëpunim, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet".
- 3- Neni 249 i K.Penal "Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij", parashikon: "Vazhdimi i ushtrimit të funksionit shtetëror apo të shërbimit publik nga ana e pëersonit që është vënë në dijeni të vendimit apo rrethanës që u ka dhënë fund ushtrimit të tyre përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim gjer në një vit".

Nw rrethanat e mwsipwrme pwr hstetasin Agim Kajmaku duhet tw vendset tw merret i pandehur pwr kwto akuza si dhe ti nnojftohet akuza, si mw poshtw.

Mbështetur në sa më sipër, bazuar në nenin 34, pika 1 të K.Pr.Penale ;

VENDOSA :

1. Të marr të pandehur shtetasin Agim Kajmaku (i biri i Ymer dhe Maxhe, lindur me 06.07.1971 në Fushë-Prezë, Tiranë dhe banues në Gjeç, Kodër-Prezë, Tiranë, me shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i martuar) duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale të: "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 190/1 i K.Penal.
2. Të marr të pandehur shtetasin Agim Kajmaku duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve zyrtarë", e kryer në bashkëpunim me shtetaset Merita Shytko, Irma Bylyku dhe Mirjeta Mema, e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 186/2 i K.Penal..
3. Të marr të pandehur shtetasin Agim Kajmaku duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale "Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij", e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 249 i K.Penal.
4. Bazuar në nenin 304/2 të K.Pr.Penale për njoftimin e aktit dhe marrjen në pyetje, si dhe njohjen me aktet e procedimit penal sipas nenit 327/2 të K.Pr.Penale (ndryshuar me ligjin nr.35/2017, datë 30.03.2017, neni 179), ngarkohet z.Klevis çifligu, O.P.Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë me juridiksion të përgjithshëm, veprime të cilat duhet të kryhen deri me datën 20.01.2020, duke ia dorëzuar dosjen dorazai sot me datën 07.01.2020.

I pandehuri duhet të njihet me kartën e të drejtave bashkangjitur këtij vendimi. T'i lexoj me zë të lartë dhe t'i shpjegoj të drejtat që i lindin dhe t'a pyes në qoftë se i kupton qartë si dhe të shprehet gjatë pyetjes me shkrim në lidhje me to.


PROKURORI


Kolë HYSENAJ

I pandehuri dhe mbrojtësi i tij morën dijeni për aktin e njoftimit të akuzës në orën 13.12, të datës 10/01/2020

I pandehuri

Avokati





10.01.2020
13.12
10.01.2020